



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK DHE
RAPORTIMIT FINANCIAR
DREJTORIA E HARMONIZIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 1570 Prot.

Tiranë, më 27/1, 2026

Lënda: Njoftim për hapjen e procesit së aplikimeve të kandidatëve për trajnerë për trajnimin e vazhdueshëm profesional të audituesve të brendshëm në detyrë në sektorin publik, për vitin 2026.

Në zbatim të urdhrit nr.165, datë 31.12.2025, të Ministrit të Financave "Për miratimin e Programit të Trajnimit të Vazhdueshëm Profesional për Audituesit e Brendshëm në Sektorin Publik, për vitin 2026", Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm njofton fillimin e procesit të aplikimeve të kandidatëve për trajnerë për trajnimin e vazhdueshëm profesional të audituesve të brendshëm në detyrë në sektorin publik, për vitin 2026.

Përzgjedhja e trajnerëve për trajnimin e vazhdueshëm profesional të audituesve të brendshëm në detyrë në sektorin publik, për vitin 2026, kryhet nga Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm.

Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm, përcakton numrin e nevojshëm të trajnerëve dhe i përzgjedh ata, në përputhje me kriteret e më poshtme:

Trajnerët e kategorisë së parë duhet të plotësojnë një nga kërkesat e mëposhtme:

- Diplomë "Master i Shkencave" ose "Master i Arteve" apo të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe 6 deri 10 vite përvojë pune në fushën përkatëse.
- Diplomë postmaster apo të barazvlefshme me të, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe minimalisht 3 vite përvojë pune në fushën përkatëse.

Trajnerët e kategorisë së dytë, duhet të plotësojnë një nga kërkesat e mëposhtme:

- Diplomë "Master i Shkencave" ose "Master i arteve" apo të barazvlefshme me to, sipas legjislacionit të arsimit të lartë dhe mbi 10 vite përvojë pune në fushën përkatëse.
- Gradë apo titull shkencor dhe minimalisht 7 vite përvojë pune në fushën përkatëse.

Trajnerët e kategorisë së parë dhe trajnerët e kategorisë së dytë, duhet të plotësojnë edhe kriteret e mëposhtme:

- Njohuri të mira të standardeve profesionale të auditimit të brendshëm dhe të kenë përvojë praktike në fushën e auditimit të brendshëm në sektorin publik.
- Aftësi për të prezantuar temat e programit të trajnimit.
- Aftësi për të shpjeguar në një mënyrë të thjeshtë përmbajtjen e programit të trajnimit.

- d) Aftësi për t'ju përgjigjur pyetjeve dhe komenteve të bëra nga pjesëmarrësit, duke përdorur shembuj praktikë.
- e) Të kenë aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe prezantimi.
- f) Të paktën 2 vjet eksperiencë në mësimdhënie.

Kandidatët për trajner, duhet të paraqesin në formë shkresore në Ministrinë e Financave, dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kërkesë me shkrim.
- b) Curriculum vitae.
- c) Vërtetim të eksperiencës në mësimdhënie.
- d) Vërtetim të eksperiencës në profesion.
- e) Fotokopje të noterizuar të diplomave;
- f) Rekomandime për integritet moral dhe reputacion të mirë.

Pranimi i dokumentacionit për trajnerë, do të bëhet brenda 15 ditëve kalendarike, nga data e shpalljes së këtij njoftimi.

Kandidatët që aplikojnë për trajnerë, dorëzojnë dokumentacionin në zyrën e protokollit në Ministrinë e Financave. Pas marrjes nga Sekretari i Përgjithshëm të dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët, Drejtoria e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, kryen vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur dhe harton listën e kandidatëve që plotësojnë kërkesat formale.

Lista e kandidatëve së bashku me dokumentacionin shoqërues, i përcillet për vendimmarrje Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik.

Komisioni i Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, shpall listën emërore të kandidatëve për trajner.

Me trajnerët e përzgjedhur, Nëpunësi i Parë Autorizues, lidh kontratë individuale sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.116, datë 17.02.2016 “Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjes së komisionit të kualifikimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit”, i ndryshuar.

Informacioni për Programin e Trajnimit të Vazhdueshëm Profesional të audituesve të brendshëm për vitin 2026, gjendet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave, www.financa.gov.al

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Besmir Beja

